

# Qëndrueshmëria në sprovë

## Shqipëria



## Shqipëria

- Gjatë vitit 2022, ekonomia e Shqipërisë vijoi rimëkëmbjen e fortë, pavarësisht rritjes së çmimeve të ushqimeve dhe energjisë.
- Inflacioni i lartë i ushqimeve dhe energjisë ka nxitur ofrimin e mbështetjes shtesë nga qeveria për familjet dhe bizneset. Pritjet e larta inflacioniste kanë nxitur shtrëngim më të shpejtë të politikës monetare.
- Në kontekstin e shtrëngimit të kushteve të financimit në tregjet ndërkombëtare, vijimit të ngadalësimit ekonomik në Evropë dhe ndërprerjes së masave mbështetëse të politikës për krizën energjetike, perspektivat e rritjes ekonomike së Shqipërisë varen nga rimëkëmbja ekonomike globale, ritmi i zbatimit të agjendës së reformave dhe planeve të konsolidimit fiskal.

### Zhvillimet e Fundit Ekonomike

#### **Gjatë vitit 2022, ekonomia vijoi rimëkëmbjen e fortë, pavarësisht rritjes së çmimeve të ushqimeve dhe energjisë.**

Ekonomia e Shqipërisë u zgjerua mesatarisht me 4.84 për qind në vitin 2022 dhe rritja rezultoi me bazë të gjerë. Kontribuesi kryesor në rritjen ekonomike ishte konsumi privat, që u zgjerua me 7.2 për qind në terma realë, pavarësisht rritjes së çmimeve të energjisë dhe ushqimeve. Gjithashtu, formimi i kapitalit fiks bruto vijoi rritjen e fortë me 6.53 për qind, pas zgjerimit me 19.2 për qind një vit më parë. Në të kundërt, kontributi i kërkesës së huaj neto në rritjen ekonomike ishte negativ pasi deficitit tregtar u zgjerua me 29 për qind në terma realë.

**Në anën e ofertës, tregtia dhe ndërtimi ishin sektorët që udhëhoqën rritjen ekonomike në vitin 2022.** Megjithatë, pushtimi i Ukrainës nga Rusia krijoi probleme në ritmet e rritjes ekonomike pasi goditjet e ofertës u reflektuan në presione të shtuara mbi kostot dhe rritje të pasigurisë, veçanërisht në sektorë të tillë is bujqësia dhe prodhimi. Ulja e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet, e shkaktuar nga kushtet e pafavorshme atmosferike, rriti nevojën për importe të energjisë dhe kontribuoi negativisht në rritjen

ekonomike. Ndërkohë, sektori i shërbimeve u ndikua më pak dhe vijoi zgjerimin duke u rritur me 5.9 për qind në vitin 2022, si rezultat i kërkesës së fortë konsumatore dhe një sezoni të jashtëzakonshëm turistik. Në vitin 2022, numri i turistëve u rrit me 27.5 për qind dhe numri i netë qëndrimeve me 20 për qind.

**Rrjedhimisht, përmirësimet në kushtet e tregut të punës në vitin 2022 rezultuan me bazë të gjerë.** Rritja vjetore e punësimit u përshpejtua në 4.0 për qind në vitin 2022. Krijimi i vendeve të reja të punës ishte i pranishëm në shumë sektorë, ndërkohë që u rrit dhe numri i vendeve të lira të punës, duke ushtruar në këtë mënyrë presion për rritje të pagave, veçanërisht për punonjësit më të kualifikuar. Shkalla e papunësisë ra në 11.0 për qind në vitin 2022, ndërkohë që u rrit pjesëmarrja në forcën e punës. Megjithatë, rritja e punësimit filloi të ngadalësohet në gusht 2022 për bizneset në sektorin e industrisë dhe atë të shërbimeve. Pagat gjithashtu reflektuan përmirësimin e kërkesës për punë dhe u rritën me 10.8 për qind në T4 2022, duke vijuar në trendin rritës të nisur në fillim të vitit.

**Presionet inflacioniste u intensifikuan pas pushtimit të Ukrainës nga Rusia.** Norma mesatare e inflacionit gjatë vitit 2022 ishte

6.7 për qind, e ndikuar nga çmimet e ushqimeve dhe transportit. Rritje të tilla po ndikojnë negativisht tek qytetarët më të varfër, duke pasur parasysh peshën më të madhe që kanë këto artikuj në shportën e tyre të konsumit. Megjithatë, inflacioni në Shqipëri mbetet më i ulët se në vendet e tjera me zhvillim të ngjashëm, për disa arsye.

**Së pari, prodhimi i energjisë elektrike nga hidrocentralet, që megjithëse nuk ishte në gjendje të plotësonte deri në 85 për qind të kërkesës së brendshme për energji, siç do të ndodhte në një vit me reshje mesatare, siguroi gjithësesi njëfarë mbrojtje nga kriza e vazhdueshme energjetike.** Së dyti, kursi i këmbimit të monedhës vendase ndaj euros vijoi të mbiçmohet (me 4.9 për qind në dhjetor), duke frenuar kështu transmetimin e inflacionit të importuar në ekonominë vendase. Së treti, rritjet e çmimeve të energjisë u frenuan për shumicën e bizneseve dhe familjeve (klientët me çmime “ të rregulluara”, pra konsumatorët e tensionit të mesëm dhe të ulët). Së fundi, për karburantet e transportit dhe artikujt kryesorë ushqimorë u vendosën përkohësisht çmime të kontrolluara. Goditjet e vazhdueshme nga ana e ofertës krijuan efekte të raundit të dytë. Inflacioni është bërë me bazë më të gjerë, ndërsa komponentët, të cilët priren të jenë më të luhatshëm, kanë qenë më të qëndrueshëm. Kjo reflektohet nga fakti se prej gushtit 2022, inflacioni bazë—pra inflacioni që nuk përfshin artikujt e ushqimit dhe energjisë—ka qenë pak më i lartë se IÇK mesatare. Në nëntor 2022, inflacioni bazë ishte 8.3 për qind krahasuar me mesataren afatgjatë prej 0.8 për qind gjatë periudhës 2015–21. Pritjet inflacioniste gjithashtu filluan të pasqyrojnë këto trende.

**Rritja e pritjeve inflacioniste nxiti përshpejtimin e normalizimit të politikës monetare.** Banka e Shqipërisë (BSH) në nëntor rriti përsëri normën bazë të interesit me 0.50 pikë përqindje duke e çuar atë në nivelin 2.75 për qind, dhe kjo shënon rritjen e pestë në vitin 2022. Pavarësisht shtrëngimit më të shpejtë, kushtet monetare janë ende të favorshme, pasi normat reale të interesit mbeten negative, duke reflektuar rritjen e inflacionit dhe pritjet inflacioniste. Me normalizimin e politikës monetare dhe pritshmëritë e mëtejshme për shtrëngim të politikës monetare, yield-et në tregun vendas të letrave me vlerë të qeverisë kanë filluar të rriten, dhe ankandet, veçanërisht për segmentin e letrave me vlerë afatgjatë, kanë qenë për një kohë të shkurtër me kërkesë më të vogël se oferta. Ankandet filluan të normalizohen në tetor 2022.

**Kredia për sektorin privat vijoi ecurinë e fortë pozitive të vitit 2021 si për bizneset ashtu edhe për individët.** Pavarësisht rritjes së normave të interesit, kredia për sektorin privat u rrit me 7 për qind në vitin 2022. Kostot e larta të prodhimit për bizneset u përkthyen në kërkesë më të madhe për kapital qarkullues. Raporti i kredive me probleme ndaj totalit të kredive ishte 5.0 përqind në dhjetor 2022, duke reflektuar jo vetëm cilësinë e mirë të asetëve, por edhe forcimin e ndjeshëm të ritmit të rritjes së kredisë gjatë tre viteve të fundit. Gjatë së njëjtës periudhë, totali i depozitave u rrit me 4.6 për qind. Rritja e depozitave në monedhë të huaj reflektoi flukset më të larta hyrëse nga eksportet turistike dhe flukset hyrëse të qëndrueshme të remitancave gjatë vitit 2022. Ndërsa raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit bankar tejkalon kërkesat rregullatore, sistemi bankar mbetet i ndjeshëm ndaj rreziqeve të kredisë, kursit të këmbimit dhe normës së interesit, duke reflektuar peshën e lartë (një e katërta e

totalit të kredive) të huave të pambrojtura në monedhë të huaj (FX), mbizotërimin e kredive bankare me norma të ndryshueshme interesi dhe mbajtjen e sasive të mëdha të obligacioneve të qeverisë.

**Pavarësisht rritjes së çmimeve të importeve, deficitit i llogarisë korente të Shqipërisë u zvogëluar në 6 për qind të PBB-së, kryesisht falë rritjes së jashtëzakonshme të eksporteve turistike.** Eksportet e mallrave (veçanërisht mineralet, metalet, materialet e ndërtimit, energjia dhe nafta bruto) gjithashtu shënuan rritje të lartë prej 48.6 për qind, kryesisht për shkak të rritjes së çmimeve ndërkombëtare. Importet u rritën me 23.1 për qind, të nxitura më së shumti nga rritja e importeve të mallrave, mineraleve, energjisë, lëndëve djegëse të përpunuara dhe ushqimeve, të ndikuara edhe nga goditja në kushtet e tregtisë. Pavarësisht rritjes së ngadaltë në vendet pritëse, dërgesat e emigrantëve shqiptarë u rritën me 9.8 për qind. Flukset hyrëse të investimeve direkte u rritën me 34.8 për qind në total dhe shënuan një rritje dyshifrore në sektorët e pasurive të paluajtshme, industrisë nxjerrëse, energjisë, sektorin financiar dhe të sigurimeve, si dhe në industrinë përpunuese. Stoku i rezervave valutore mbeti i fortë në nivelin 5 miliardë euro (ose 6.9 muaj importe) në fund të nëntorit 2022.

**Performanca e fortë e të ardhurave në 2021 dhe 2022 ndihmoi në zbutjen e ndikimit fiskal të përgjigjes së Qeverisë së Shqipërisë ndaj goditjeve dhe uljen e deficiteve fiskale.** Në vitin 2022, pozicioni fiskal u forcua akoma më shumë falë rritjes së fortë të të ardhurave dhe kufizimit të shpenzimeve në kushtet e pasigurisë të lartë. Për të ofruar mbështetje të përkohshme dhe të shënjestruar për grupet më të cënueshme nga kriza, qeveria rishikoi buxhetin katër herë

gjatë vitit 2022, në mars, korrik dhe dy herë në dhjetor, duke kompensuar shpenzimet për këtë mbështetje me ulje të shpenzimeve kapitale. Mbështetja për familjet dhe bizneset arriti në 0.6 për qind të PBB-së, ndërkohë që subvencionet shtesë të akorduara për blerjet e energjisë për ndërmarrjet shtetërore (NSH) të energjisë elektrike arritën në 1 për qind të PBB-së. Shpenzimet shtesë u financuan tërësisht nëpërmjet rialokimit të shpenzimeve dhe rritjes së fortë të ardhurave për shkak të përpjekjeve të administratës tatimore, çmimeve më të larta dhe rritjes së vazhdueshme ekonomike.

### **Perspektiva dhe Rreziqet**

**Në kontekstin e shtrëngimit të kushteve të financimit në tregjet ndërkombëtare, ngadalësimit të pritshëm të rritjes ekonomike në Evropë dhe ndërprerjes së masave mbështetëse të politikës të lidhura me rindërtimin pas tërmetit, rritja ekonomike e Shqipërisë për vitin 2023 pritet të mbetet e ulët.** Eksportet, konsumi dhe investimet reale pritet të rriten me ritme më të ngadalta se ato në periudhën para pandemisë. Importet reale pritet të rriten me 3.4 për qind në vitin 2023, duke pasur parasysh perspektivën e sektorëve me intensitet më të ulët të importit, si industria përpunuese. Nga ana e ofertës, sektori i shërbimeve pritet të vijojë të jetë kontribuesi kryesor i rritjes ekonomike, i shoqëruar nga sektori i ndërtimit, siç mund të evidentohet dhe nga rritja e numrit të lejeve të ndërtimit të lëshuara për ndërtesat e reja në fund të vitit 2022. Industria dhe, në një masë më të vogël, bujqësia, ka të ngjarë të vijojnë të ndikohen nga kostot e rritura të prodhimit. Sipas skenarit bazë të përmirësimit të perspektivave të rritjes ekonomike në BE dhe normalizimit gradual të çmimeve në tregjet ndërkombëtare, nga viti

2024 e në vijim, rritja ekonomike pritet të jetë me bazë të gjerë.

**Inflacioni parshikohet që të fillojë të ulet gradualisht në vitin 2023 dhe të kthehet në objektivin 3 për qind të BSH-së në mesin e vitit 2024.** Megjithatë, tensionet e zgjatura gjeopolitike mund të rrisin më tej inflacionin, të krijojnë probleme në zinxhirët e furnizimit dhe shqetësime në tregjet financiare. Në përgjigje të rritjes së presioneve të brendshme inflacioniste dhe rritjes së pritjeve inflacioniste, në kuadër të normalizimit të politikës monetare në vendet e zhvilluara, banka qendrore pritet të shtrëngojë më tej politikën e saj monetare. Të gjitha këto mund të zbehin akoma më shumë perspektivat e rritjes ekonomike të Shqipërisë.

**Plani i konsolidimit fiskal ka si objektiv arritjen e një bilanci primar pozitiv në vitin 2023.** Konsolidimi fiskal do të bazohet kryesisht në anën e shpenzimeve. Qeveria parashikon që të vijojë të kufizojë rritjen e pagave në sektorin publik, shpenzimet për mallra dhe shërbime, si dhe transfertat aktuale për qeveritë lokale dhe NSH-të. Kjo do të mundësohet edhe nga vijimi i reformave në sektorë kyç, si energjia dhe ndërmarjet publike të furnizimit me ujë. Në aspektin e të ardhurave, qeveria planifikon të prezantojë një sërë masash të politikës tatimore për turr të ardhurat, siç parashikohet në draftin e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave (SAA), përfshirë një regjim të ri tatimi mbi të ardhurat personale për profesionistët e vetëpunësuar, dhe një taksë të vetme solidariteti për fitimet shtesë


të prodhuesve të pavarur të energjisë elektrike. Pajtueshmëria tatimore parashikohet të përmirësohet gradualisht, nëpërmjet zvogëlimit të hendekut të pajtueshmërisë me TVSH-në, ekonomisë cash, punës së padeklaruar, nën-deklarimit, rregullimeve artificiale për shmangien e taksave dhe përmes përmirësimit të administratës doganore duke zgjeruar marrëveshjet e shkëmbimit të informacionit. Miratimi i një SAA-je të mirë do të krijojë mundësinë e kryerjes së një konsolidimi më ambicioz, të bazuar në të ardhura.

**Për sa i përket llogarisë së jashtme, eksportet e shërbimeve, përfshirë turizmin dhe operacionet e proceseve të biznesit në zgjerim të shpejtë, pritet të mbeten të forta.** Deficiti tregtar parashikohet të rritet në 12.8 për qind të PBB-së në vitin 2023 krahasuar me 10.4 për qind në vitin 2022 dhe të qëndrojë në këto nivele në periudhë afat mesme. Flukset hyrëse të IHD-ve, përfshirë në turizëm, energji dhe industrinë përpunuese, parashikohet të financojnë pjesën më të madhe të deficitit të llogarisë korente gjatë periudhës së parashikuar.

**Krijimi i mundësive për rritje të mëtejshme ekonomike kushtëzohet nga zbatimi i shpejtë i programit të reformave të qeverisë.** Reformat, të lidhura me perspektivën e anëtarësimit në BE, pritet të nxisin rritjen e produktivitetit, edhe nëpërmjet përmirësimit të mjedisit të biznesit, thjeshtimit të proceseve të ndërveprimit të qeverisë me sektorin privat dhe zgjerimit të integritit të Shqipërisë në tregjet e huaja.

## Sektori i turizmit përjetoi një numër të paprecedentë të vizitorëve dhe netë qëndrimeve.


Numri i netë qëndrimeve nga vizitorët jo-rezidentë në vit (milionë)



Burimi: INSTAT.

## Inflacioni total dhe ai bazë u rritën ndjeshëm.


Përqind, v/v



Burimi: INSTAT.

## Rritja e fortë e të ardhurave ndihmoi në zbutjen e efekteve fiskale të përgjigjes së Qeverisë së Shqipërisë ndaj goditjeve.

Bilanci i përgjithshëm fiskal, përqind e PBB-së




Burimi: Ministria e Financave.

Shënim: f = parashikim.

## Pavarësisht rritjes së çmimeve të energjisë dhe ushqimeve, rritja e PBB-së pritet të jetë 4.8 për qind në vitin 2022.


Rritja e PBB-së dhe kontributet në rritje, përqind



Burimi: INSTAT.

## Pavarësisht importeve më të larta, bilanci i llogarisë korente u përmirësua, për shkak të rritjes së eksporteve.


Përqind e PBB-së



Burimi: Banka e Shqipërisë.

## Varfëria pritet të vijojë trendin rënës në vitin 2022.

Përqind e popullsisë



Burimi: Ministria e Financave, përllogaritje të Bankës Botërore.

Shënim: PPP = pariteti i fuqisë blerëse.

SHQIPËRIA Tregues të Përzgjedhur Ekonomikë	2020	2021	2022e	2023f	2024f	2025f
Rritja e PBB-së Reale (në përqindje)	-3.3	8.9	4.8	2.8	3.3	3.3
Përbërja (pikë përqindje):						
Konsumi	-2.5	3.6	6.7	2.1	2.2	2.1
Investimet	-0.8	4.6	1.7	-0.2	0.8	0.7
Eksportet neto	0.0	0.7	-3.6	0.9	0.3	0.4
Ekportet	-9.4	13.0	2.6	1.0	2.0	2.2
Importet (-)	-9.3	12.3	6.2	0.1	1.7	1.8
Inflacioni i çmimeve të konsumit (në përqindje, mesatare e periudhës)	2.2	2.6	6.7	4.0	3.5	3.0
Të ardhura publike (për qind e PBB-së)	25.9	27.5	26.8	28.2	27.8	27.8
Shpenzimet publike (për qind e PBB-së)	32.6	32.1	30.5	30.6	30.2	30.2
Prej të cilave:						
Shpenzime për paga (për qind e PBB-së)	4.7	4.5	4.0	4.3	4.1	4.1
Asistencë sociale (për qind e PBB-së)	13.4	12.3	11.6	11.6	11.2	11.3
Shpenzime kapitale (për qind e PBB-së)	6.2	6.9	6.6	5.4	5.3	5.2
Bilanci fiskal (për qind e PBB-së)	-6.7	-4.6	-3.7	-2.4	-2.4	-2.4
Bilanci primar fiskal (për qind e PBB-së)	-4.6	-2.7	-1.8	0.2	0.6	0.4
Borxhi Publik (për qind e PBB-së)	73.0	71.5	62.1	60.3	59.4	58.5
Borxhi publik dhe i garantuar (për qind e PBB-së)	75.8	75.4	65.4	63.6	62.7	61.8
Prej të cilit: I Jashtëm (për qind e PBB-së)	35.2	36.8	30.3	30.1	29.6	28.1
Eksportet e mallrave (për qind e PBB-së)	6.0	8.3	10.8	11.0	11.0	11.0
Importi i mallrave (për qind e PBB-së)	28.4	33.6	34.6	39.2	39.1	38.9
Eksportet neto të shërbimeve (për qind e PBB-së)	8.1	11.7	13.4	15.5	15.1	15.0
Bilanci tregtar (për qind e PBB-së)	-14.3	-13.5	-10.4	-12.8	-13.0	-12.9
Fluksi hyrës neto i remitancave (për qind e PBB-së)	5.1	5.0	5.5	5.5	5.5	5.4
Bilanci i llogarisë korente (për qind e PBB-së)	-8.5	-7.8	-6.0	-7.1	-7.1	-7.0
Flukset hyrëse neto të Investimeve të huaja direkte (për qind e PBB-së)	6.7	6.5	6.7	6.8	6.8	6.9
Borxhi i jashtëm ( për qind e PBB-së)	60.5	62.7	54.3	51.8	50.0	49.0
Rritja reale e kredimit privat (në përqindje, mesatare e periudhës)	4.6	5.5	2.9	-	-	-
Kreditë me probleme (përqindje e totalit të kredive, fundi i periudhës)	8.1	5.7	5.0	-	-	-
Shkalla e papunësisë (në përqindje, mesatare e periudhës)	11.7	11.5	11.0	-	-	-
Shkalla e papunësisë e të rinjve (në përqindje, mesatare e periudhës)	20.9	20.9	20.7	-	-	-
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës (në përqindje, mesatare e periudhës)	59.5	59.8	62.4	-	-	-
PBB për frymë, PPP (Dollarë ndërkombëtar korent)	14,888	16,302	16,782	17,151	17,734	18,515
Shkalla e varfërisë (në përqindje të popullsisë)	34.4	27.5	25.2	23.9	22.0	20.4

*Burimet:* Autoritetet e Vendit, Vlerësime dhe parashikime të stafit të Bankës Botërore.

*Shënim:* Norma e papunësisë për të rinjtë i referohet forcës së punës në grupmoshën 15-29 vjeç. Mospërputhja statistikore në kontribut është shpërndarë në raportin 80 përqind me 20 përqind midis Konsumit dhe Investimeve përkatësisht. Ndryshimi në inventare është përfshirë në Investime. Llogaritjet e shkallës së varfërisë bazuar në harmonizimin ECAPOV duke përdorur të dhënat AANJ të vendit. Vlerat e parashikuara për periudhat aktuale/të ardhme fillojnë në vitin 2020. Treguesit e të ardhurave të matur sipas AANJ dhe treguesit e konsumit të matura sipas ABF nuk janë plotësisht të krahasueshme. Varfëria përkufizohet si jetesa me më pak se 5.5 dollarë/ditë për person të rregulluar sipas PPP të rishikuar të vitit 2011.



Raporti I Rregullt Ekonomik Për **Ballkanin Perëndimor**  
Nr. 23 | pranverë 2023

---

Shikoni raportin online:  
[www.worldbank.org/eca/wbrer](http://www.worldbank.org/eca/wbrer)